

## PËRKTHIMET DHE LIBRAT LITURGJIKË NË SHQIP

Ishte dhe mbetet gjithnjë e gabuar pikëpamja, sipas së cilës fjalët e Perëndisë dhe lutjet e shenjta mund të shprehen vetëm në tri gjuhë: hebraisht, greqisht dhe latinisht, gjuhë të konsideruara si të shenjta. Një pikëpamje e tillë është në kundërshtim jo vetëm me zhvillimin gjuhësor të Shkrimeve të Shenjta, por edhe me vetë frymën e Krishterimit dhe me praktikën e Kishës.

Ja ç'tregojnë faktet:

Dihet se Perëndia ia shfaqti vullnetin e tij Moisiut për popullin izraelit në gjuhën hebraike. Po, kur ky popull, me kalimin e shekujve, e ndryshoi gjuhën, duke përdorur, në vend të saj, aramaishten, një dialekt siro-kaldeas, librat e fundit të Dhiatës së Vjetër u shkruajtën në këtë gjuhë të gjallë të popullit. Po në këtë gjuhë bëhej përkthimi dhe shpjegimi i librave të parë të Dhiatës në Tempullin e Jerusalemit dhe në sinagogat e tjera.

Më vonë kur një pjesë e këtij populli, i shtrënguar nga rrethana të ndryshme historike, ishte i detyruar të largohet nga Palestina e të vendoset në vende të tjera; filloi dalëngadalë ta harrojë gjuhën aramaiste, por jo dhe Perëndinë, siç është rasti i hebrenjve të Aleksandrisë së Egjiptit, të cilët në vend të aramaistes përdorën greqishten. Më 280 para Krishtit u përkthye në këtë gjuhë, që flitej dhe kuptohej nga populli, edhe Dhiata e Vjetër, përkthim i cili njihet me emrin "i të 70-ve" ose më saktë "i të 72-ve".

Zoti dhe Shpëtimtari ynë Iisu Krisht, pak kohë para ngjitjes së tij në qiell, i porositi nxënësit e tij: *"Shkoni dhe mësoni gjithë kombet ... të ruajnë sa ju kam porositur"*<sup>1</sup>.

Dhe nxënësit e tij e zbatuan këtë porosi. Ungjillori Mark, në ungjillin e tij të shkruar rreth vitit 63 pas Krishtit, thotë: *"edhe ata dolën dhe predikuan kudo..."*<sup>2</sup>.

Po në ç'gjuhë e lexonin Ungjillin e Zotit apostujt e shenjtë dhe nxënësit e tyre? *"Ç'do populli në gjuhën e tij"*.

*"Besimi (d.m.th. pranimi i krishterimit), thotë Apostull Pavli, vjen nga të dëgjuarit"*<sup>3</sup>, sepse *"si mund të besojnë (njerëzit) në Atë, për të cilin s'kanë dëgjuar gjë? Si do të dëgjojnë, pa ndonjë predikues (lexues -sic)"*<sup>4</sup>, i cili të njohë gjuhën e atyre që u flet?

Dhe në një vend tjetër Apostull Pavli thotë: *"në Kishë dëshiroj më mirë të them pesë fjalë të kuptueshme që të mësoj dhe të tjerët, se sa dhjetëmijë fjalë në gjuhë të pafrymtë (të panjohur)"*<sup>5</sup> d.m.th. në gjuhë të huaj për ata, të cilëve u flitet për Krishtin.

Është e qartë, pra, se që ta njihnin njerëzit Krishtin dhe t'i besonin Atij,

---

<sup>1</sup> Mt. 28:19-20

<sup>2</sup> Mk. 16:20

<sup>3</sup> Rom.10:17

<sup>4</sup> Rom. 10:14

<sup>5</sup> 1Kor.14:19

"Iajmi i mirë" i Ungjillit duhej t'u lexohej dhe t'u jepej në gjuhën e tyre.

Kështu ka vepruar edhe Kisha qysh në shekujt e parë.

Librat e shenjta të Dhiatës së Re dihet se janë shkruar në gjuhën greke, me përjashtim të Ungjillit të Mattheut, që u shkrua në gjuhën aramaike (por që u përkthye edhe ky në gjuhën greke), sepse në atë kohë, kjo gjuhë - dhe jo gjuha latine, gjuha e pushtuesit të atëhershëm të botës së vjetër dihej nga të gjithë popujt, që ishin nën pushtimin e perandorisë së fuqishme romake.

Nga greqishtja, pastaj ato u përkthyen dhe në gjuhë të tjera, në fillim në gjuhën siriane, përkthim që njihet me emrin "Vetus syra", pastaj në gjuhën latine, që njihet me emrin "Itala" (shek. II).

Origjeni, shkrimtar i madh kishtar i fillimit të shek. III, në veprën e tij "Kundër Kelsit" thotë: *"Të krishterët në lutjet e tyre nuk përdorin emrat që ndodhen në shkrimet hyjnore dhe që janë caktuar për Perëndinë (sikundër ngjet nëpër magjitë, ku ndalohet edhe ndryshimi më i vogël), por grekët greqisht dhe romanët latinisht dhe kështu secili në dialektin e tij i falet Perëndisë dhe e himnon ashtu si mundet. Dhe Zoti i çdo dialekti i dëgjon ata që i luten në çdo gjuhë; dhe që të them kështu i dëgjon të gjitha sikur thuhen me një zë; se Perëndia, i cili është i të gjithëve nuk ka zgjedhur me short ndonjë gjuhë barbare a greke dhe as që s'i di gjuhët e tjera ose s'i merr parasysh ata që falen në gjuhë të tjera..."*<sup>6</sup>.

Efsevi, ati i historisë kishtare, që ka jetuar në shek. IV thotë: *"se (pas ardhjes së Krishtit) iu dha gjithë kombeve (e drejta) të përdorin gjuhë të ndryshme që ka çdo komb (dhe përpara Krishtit) po Perëndia urdhëroi që profecitë të kuptohen nga të gjithë kombet me anën e shpjegimit"*<sup>7</sup>.

Edhe jo vetëm Shkrimet e Shenjta, por edhe shërbesat kishtare, u pa e udhës të shpjegohen në gjuhën e çdo populli, që të jenë, të kuptueshme.

Në liturgjinë më të vjetër të ritit aleksandrin, që është e shek. IV pas Krishtit, ndërmjet kategorive të tjera të punonjësve në Kishë gjejmë edhe interpretët [*ἐρμηνεῖς*], të cilët kishin për detyrë të përkthenin shërbesën dhe predikimin për ata që nuk e kuptonin gjuhën greke<sup>8</sup>.

Për një kategori të tillë përkthyesish na flet edhe Etheria (shek. IV), e cila thekson se në Kishën e Jerusalemit këta përkthenin shërbesën nga gjuha greke, në të cilën meshohej, në gjuhën siriane, për ata që nuk e kuptonin të parën<sup>9</sup>.

Armenët e kanë përdorur gjuhën e tyre në kishë që në shek. III pas Krishtit.

Këtë rregull Kisha Orthodhokse e ka ndjekur pothuaj vazhdimisht, me përjashtime të rralla.

Misionarët e saj, që dërgoheshin nga Konstandinopoja nëpër popujt e

<sup>6</sup> Kundër Kelsit VII, vol. II., 1593, A. Migne Patr. Graeca 1844-1866, Paris.

<sup>7</sup> Efsevi: Ungjijtë, shih Prokopi VIII (Hyrje).

<sup>8</sup> "Ortodoksia" revista Patriarhiei Romane, Viti XI, Nr. 2, prill-maj 1959, faqe 289, Bucuresti.

<sup>9</sup> Si më sipër.

ndryshëm për të përhapur Krishterimin, krahas me leximin dhe organizimin, interesoheshin dhe për përkthimin e librave të shenjtë në gjuhën e atyre popujve.

Ulfila, apostull i gotëve dhe i pari episkop i tyre, stërnip i disa të krishterëve kapadoqeas, njohës i mirë i gjuhës gotike, latine dhe greke, i cili ka jetuar në shek. IV, krahas me punën misionare për kthimin e gotëve në Krishterim, përktheu dhe Biblën në gjuhën gotike<sup>10</sup>.

Apostujt e popujve sllavë Qirilli dhe Metodi, të dërguar nga Patrikana e Konstandinopojës në shek. IX për të kthyer në Krishterim moravasit përkthejnë në gjuhën sllave Shkrimet e Shenjta dhe bëjnë një luftë të ashpër për futjen e kësaj gjuhe në shërbesat kishtare<sup>11</sup>.

Veprën e Qirillit dhe të Metodit e vazhdojnë nxënësit e tyre Shën Klementi, Shën Naumi e të tjerë, që vunë bazat e gjuhës kishtare edhe në Kishën Orthodhokse Bullgare.

Në shek. XV Shën Sava, i dorëzuar kryepiskop i Kishës Orthodhokse Serbe, prej patrikut të Konstandinopojës në Nike, krahas me organizimin e Kishës, cakton që shërbesat kishtare të kryhen në gjuhën e popullit<sup>12</sup>.

Në bazë të dokumentave të njohura gjer tani<sup>13</sup>, në Kishën Orthodhokse Rumune, përpjekjet e para të përkthimit të librave kishtare në gjuhën e popullit fillojnë në shek. XV dhe më vonë, që në shek. XVII, përkthimi të bëhet i plotë dhe gjuha rumune të përdoret gjerësisht në Kishë.

Këto pra, na tregojnë historia e Kishës.

Po në Kishën tonë Orthodhokse të Shqipërisë, si qëndron kjo çështje?

Pikërisht, këtë do të analizojmë në pjesën që pason.

## II

Përkthimi më i vjetër që njohim deri tani në lidhje me temën që trajtohet, i përket *shek. XV*. Është një dorëshkrim që u gjend brenda një dorëshkrimi tjetër greqisht, në bibliotekën Ambroziana të Milanos. Përmban tri pjesë të ndryshme:

**1. Ungjillin e Shërbesës së Mëngjesit të së Premtes së Madhe**, që këndohet pas procesionit me Epitafin (Mt. 27: 62-66).

**2. Urimin "Për shumë vjet, o Kryezot"**, që këndohet nga psalti kur episkopi bekon popullin pas mbarimit të leximit të Ungjillit nga dhiaku.

**3. Himnin e Pashkës së Madhe "Krishti u ngjall"**, që është himni

---

<sup>10</sup> Istoria bisericeasca universala, Vol. I, Bucuresti 1956, faqe 191.

<sup>11</sup> Si më sipër, faqe 329-330.

<sup>12</sup> Hrisostom Papadhopullos, Αἱ ὁρθόδοξοι Ἐκκλησίαι Σερβίας καί Ρουμανίας, Ἐν Ἱερουσαλύμοις, 1923, faqe 8.

<sup>13</sup> Istoria Bisericii Romane, Vol. I, Bucuresti, 1957, faqe 252.

më i njohur dhe më i përhapur ndër orthodhoksët gjatë 40 ditëve të Pashkës<sup>14</sup>.

Natyrisht kjo s'do të thotë se përpjekjet për të përkthyer Shkrimet e Shenjta në gjuhën shqipe dhe për përdorimin e tyre në Kishë, fillojnë në shek. XV.

*"Fragmentet, theksohet në Historinë e Letërsisë Shqipe, flasin për përdorimin sado të pjesshëm të shqipes në shërbesat fetare të Kishës Orthodhokse para pushtimit turk. Ato janë thërrmijat e një prodhimi që është zhdukur, gjurmët e një tradite të lashtë letrare"*<sup>15</sup>.

\* \* \*

E njëjta gjë mund të thuhet dhe për shek. XVI e XVII, periudhë për të cilën nuk ka dalë deri tani në dritë asnjë e dhënë ose njohuri për përpjekje të tilla.

*"Është më afër mendsh, shkruan Eqerem Çabej, që për nevoja kishtare të jetë shkruar shqipja edhe ndër orthodhoksë të Shqipërisë së mesme e jugore. Prandaj më duket me vend porosia e Mario Roques, që këshillon të bëhen gjurmime të këtij drejtimi në Stamboll, si edhe vetë në Shqipëri"*<sup>16</sup>.

\* \* \*

Përkundrazi, shek. XVIII është i pasur në këtë drejtim.

Tipografi **GRIGOR KONSTANDINIDHI**, njeri me kulturë të gjerë, nxënës i Akademisë së Voskopojës dhe profesor për një kohë në të, ndërmjet veprave të tjera, na thotë bashkëkohësi i tij J. Zavira *"përktheu **Dhiatën e Vjetër dhe të Re** dhe e shkroi atë me gërma shqipe, të cilat ai i shpiku vetë"*<sup>17</sup>. Kjo vepër mjerisht ka humbur. Për veprimtarinë e tij të gjerë në lëmin e kulturës dhe të mbrojtjes së Orthodhoksisë në vendin tonë, Patrikana Ekumenike e zgjodhi dhe e emëroi Mitropolit të Durrësit, që ishte Mitropolia më kryesore nga pikëpamja historike dhe fetare në Shqipëri, me qendër ndoshta në Elbasan dhe sidomos në Manastirin e Shën Joan Vladimirit, manastir i cili u bë dhe qendër për lëvizjen e përkthimit të librave të Kishës në gjuhën shqipe për Elbasanin, dhe ku janë gjetur mjaft dorëshkrime me përkthime pjesësh të ndryshme nga të Kishës<sup>18</sup>.

"**ANONIMI I ELBASANIT**", mund të ketë qenë ndonjë kallogjer ose ndonjë prift i Manastirit të Shën Jonit; dorëshkrimi i tij është zbuluar më 1949 ndërmjet dorëshkrimeve me prejardhje nga Manastiri i Shën Jonit<sup>19</sup>. Pas një predikimi prekës në gjuhën shqipe mbi vuajtjet e Krishtit, ai përkthen *pjesë*

---

<sup>14</sup> Historia e Letërsisë Shqipe, Botim i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Viti 1959, vol. I, faqe 149-150.

<sup>15</sup> Si më sipër, faqe 151.

<sup>16</sup> "Tekstet e vjetra shqip dhe disa kriteret rreth botimit të tyre", Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria "Shkencat shoqërore", Nr. 2, 1959, faqe 110.

<sup>17</sup> Historia e Letërsisë Shqipe, faqe 305.

<sup>18</sup> Aleksudhi Anthim, Σύνομος περιγραφὴ τῆς Ἱ.Μητροπόλεως Βελεγράδων, Ἐν Κερκυρα, 1868, faqe 148-149.

<sup>19</sup> Dh. S. Shuteriqi "Anonim i Elbasanit", Buletin i Institutit Shkencave, Viti III, Nr. I, faqe 33-54.

*nga Ungjilli që lexohen të dielave dhe të kremteve në kishë, si p.sh. Ungjilli i së Premtes së Madhe, i së dielës së Shën Thomait, i shërbesës së Varrimit e të tjera, të cilat nuk janë renditur sipas rregullit të Ungjillit të Madh, por që sigurisht lexoheshin në kishë, ku edhe predikohej shqip. Përkthimi është i lirë, në gjuhën e folur të asaj kohe dhe përmban fare pak fjalë të huaja. Është botuar në Buletin e Institutit të Shkencave<sup>20</sup>.*

**THEODHOR HAXHIFILIP** nga Elbasani (1730-1806), që njihet me emrin "Dhaskal Todri", nxënës edhe ky i Akademisë së Voskopojës, mësues dhe predikues i Kishës së Elbasanit, bën një hap mjaft të madh përpara. Përveç *Dhiatës së Vjetër e të Re*, ai përktheu në gjuhën shqipe *Liturgjinë e Shën Joan Gojartit*, e cila, siç dihet, është pjesa më e rëndësishme e kultit orthodhoks dhe që përdoret në kishë, pothuajse gjatë gjithë vitit. Kjo, si edhe *disa pjesë nga Orogji (Libri i Orëve)* janë botuar nga Dh. S. Shuteriqi<sup>21</sup>. Natyrisht nuk mund të pretendohet për një përkthim të rregullt e të rrjedhshëm të Liturgjisë. Dhaskali, gjatë përkthimit e ka ndjekur tekstin grek fjalë për fjalë dhe ka krijuar shumë neologjizma, që s'i përshtaten natyrës së gjuhës shqipe. Po iniciativa ishte dhe mbetet gjithnjë e lavdërueshme. Ai ka bërë dhe përkthime të tjera fetare, por mjerisht, dorëshkrimet u zhdukën prej familjes së tij më vonë, më 1827, thuhet nga frika e kolerës. Me Dhaskal Todrin kemi një përpjekje serioze për përdorimin e gjuhës shqipe në Kishë<sup>22</sup>.

Një punë të tillë bën në Berat, po gjatë këtij shekulli dhe **KONSTANDIN BERATI**. Në dorëshkrimin e tij me 152 faqe, që ruhet në Bibliotekën Kombëtare, gjenden mjaft *pjesë të shërbesave kishtare dhe të Ungjillit që përdoren në kishë*<sup>23</sup>. Madje përkthimet e tij arritën deri në Vithkuq, ndofta dhe gjetiu, me anë të dhaskalit (mësuesit) të kohës, Kost Cepi, siç provohet nga një dorëshkrim i gjetur në Manastirin e Shën Pjetrit të Vithkuqit<sup>24</sup>.

Mirëpo duhet theksuar se përkthimet që janë përmendur më lart, nuk patën ndonjë përhapje të gjerë, për faktin se nuk patën fatin të shohin dritën e botimit.

\* \* \*

Përkundrazi, ato të shek. XIX dhe të fillimit të shek. XX, që janë botuar, patën një përhapje shumë të gjerë dhe deçiduan futjen një herë e përgjithmonë në Kishë të gjuhës shqipe.

---

<sup>20</sup> Viti V, 1951, Nr. 3-4. faqe 69-130.

<sup>21</sup> Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria "Shkencat shoqërore", Viti XIII, 1959, Nr. I, faqe 166-177.

<sup>22</sup> Historia e Letërsisë Shqipe, faqe 321.

<sup>23</sup> Si më sipër, faqe 313-314.

<sup>24</sup> Dh. S. Shuteriqi, Anonim i Elbasanit "Shkrimi Shqip në Elbasan në shek. XVIII-XIX dhe Dhaskal Todri", Buletin i Institutit të Shkencave, Viti III, 1949, Nr. I, faqe 37.

**Më 1824**, episkopi GRIGOR GJIROKASTRITI boton *në Korfuz "Ungjilli sipas Mattheut"* dhe *në vitin 1827* krejt *Dhiatën e Re*, të përkthyer nën kujdesin e tij. Ky botim pati një përhapje të gjerë tek orthodhoksët e Shqipërisë dhe arbëreshët e Greqisë, aq sa më 1858 u ndie nevoja e ribotimit në Athinë<sup>25</sup>.

Megjithëse si bazë për përkthimin nuk u përdor teksti zyrtar i Dhiatës së Re, por një tekst tjetër në greqishten e re, i quajtur "Maksimim", përkthimi është bërë me kujdes në gjuhën labërishte të kohës dhe nga pikëpamja e interpretimit orthodhoks është mjaft i mirë, gjë që tregon vëmendjen e vetë episkopit në këtë drejtim, por edhe përgatitjen e tij teologjike. Është i dyti episkop shqiptar, pas Grigor Konstandinidhit, që pas botimit të Dhiatës së Re në gjuhën shqipe, gradohet nga Patrikana Ekumenike, duke u zgjedhur Mitropolit i Athinës.

Në gjysmën e dytë të shek. XIX KONSTANDIN KRISTOFORIDHI (1830-1895) nga Elbasani, vazhdues i denjë i veprës së Anonimit të Elbasanit dhe të Dhaskal Todrit, përkthen, për nevojat e Shoqërisë Biblike Britanike, *"Dhiata e Re"* të plotë, e cila u botua në *Stamboll, në dialektin verior* më 1869 dhe *në dialektin jugor* më 1879. Rreth viteve 1868-1872 përkthen dhe boton *"Psaltiri"*, një nga librat më poetikë të Dhiatës së Vjetër. Gjatë periudhës 1880-1884 shohin dritën e botimit: *"Të bërët" (Gjeneza) [Gjénesis]*, *"Të dalët" (Eksodi) [Éksodhos]* dhe *"Nomi i dytë" (Deuteronomi) [Defteronómios]*<sup>26</sup>.

Si orthodhoks i mirë, Konstandin Kristoforidhi, përveç përkthimit të Biblës interesohet dhe për edukimin fetaro-kombëtar të fëmijëve orthodhoksë, duke përkthyer dhe tekste shkollore fetare, siç janë: *"Historia e Shkronjës Shenjtëruarë"* dhe *"Katër Katekizmat"*. Dhe ajo që është më interesante për Kishën tonë ai nuk pranon të bëhet vegël e Shoqërisë Biblike Britanike për përhapjen e protestantizmit në vendin tonë<sup>27</sup>, përhapje e cila do të shkaktonte edhe një përçarje të re fetare, në dëm të interesave kombëtare të popullit tonë.

Përkthimet e Kristoforidhit nga pikëpamja gjuhësore janë më të pastra e më të përsosura nga përkthimet e paraardhësve të tij. Teksti i tij i Dhiatës së Re në dialektin jugor, i ndarë në perikopa (pjesë), sipas rregullave të rritit tonë, përdoret edhe sot në kishë. Kisha si vlerësim për punën e tij, ngriti më 1934 një bust të tij pranë Kishës së Shën Marisë në Elbasan. Përkthimet e Kristoforidhit patën një përhapje të madhe ndër orthodhoksët shqiptarë, brenda dhe jashtë atdheut, dhe i sollën një shërbim të madh çështjes së përdorimit të gjuhës shqipe në një Kishë Orthodhokse Shqiptare të pavarur.

Gjithashtu i përket *shek. XIX* edhe përkthimi i pabotuar *"Vajtimet e përmbivarrëshme të Krishtit"*, i bërë nga papa JANI I PAPANISTOS, prift i

<sup>25</sup> Historia e Letërsisë Shqipe, faqe 323.

<sup>26</sup> Dh. S. Shuteriqi "Historia e Letërsisë Shqipe" për shkollat e mesme, Tiranë, 1955, faqe 113.

<sup>27</sup> Si më sipër, faqe 114.

fshatit Godolesh të Elbasanit, i cili pas myslimanizimit të fshatit ishte vendosur, siç duket, në Manastirin e Shën Jonit. Dorëshkrimi i tij gjendet pranë arkivit të ish Institutit të Shkencave<sup>28</sup>.

Por, punën më të madhe e më të organizuar për shqipërimin e librave liturgjike dhe për përdorimin e tyre në Kishë, e bëri Imzot FAN S. NOLI, protagonist i kryesor i kombëtarizimit dhe i pavarësisë së Kishës sonë Orthodhokse.

Jemi në periudhën kur lëvizja për pavarësinë e atdheut nga robëria pesëshekullore turke kishte marrë hov të madh brenda dhe jashtë atdheut.

Për t'i shërbyer, pra, kësaj kauze edhe nga ana kishtarë, sepse Kisha jonë ishte nën varësinë e Patrikanës Ekumenike, Noli, i cili gjendej në Amerikë që më 1906, me kërkesë të shqiptarëve të atjeshëm hirotoniset (dorëzohet), më 8 mars 1908, prift nga Mitropoliti rus i Nju Jorkut, Imzot Platoni, dhe më 22 mars, të Dielën e Orthodhoksisë, celebron në Kniht Holl të Bostonit Liturgjinë e parë në gjuhën shqipe. Në pasdrekën e po asaj dite themelon në Foiniks Hoill të Bostonit kryekishën e Shën Gjergjit për shqiptarët orthodhoksë të Amerikës, që u bë qendra e përpjekjeve për pavarësinë dhe kombëtarizimin e Kishës sonë<sup>29</sup>. Nga ana tjetër, ai përkthen dhe boton në gjuhën shqipe, librat më të domosdoshëm liturgjikë, të cilët shënohen më poshtë, sipas rendit kronologjik të botimit të tyre:

### ***1. Sherbes' e Javes se Madhe, Boston Mass, 1908.***

Përmban gjithë të kënduarat prej së Shtunës së Shën L Lazarit deri të Shtunën e Madhe. U botua në Boston Mass, më 1908.

Nuk kemi parë ndonjë ekzemplar të këtij botimi.

### ***2. Librë e Shërbesave të Shënta të Kishës Orthodoxe, Boston Mass, 1909.***

Përmban shërbesën e mbrëmësore, të mëngjesit, të blatës së hyjshme, liturgjinë e Gojartit, shërbesën e pagëzimit, të martesës, të rrëfimit, të prehjes për të vdekurit, të bekimit të vogël të ujit, disa himne nga Lutjesorja (Oktoiku i vogël) dhe zbritësoret (katavasitë) e motit. Në fund ka dhe një fjalor me termat më kryesore të Kishës. U botua në Boston Mass, më 1909.

Në parathënien e këtij libri, Noli thekson: *"Po u fal shqiptarëve orthodoxë këtë librë, e cila është e dyta dhe pandeh që përdorja e saj do t'i siellë një shërbim vendit tonë. I kam dhënë zotim kombit t'im t'u jap vëllezërve të mi bashkëfetarë librat më të nevojshime për të praktikuar faljen e tyre në gjuhën kombëtare, dhe zotimin t'im do t'a mbaroj ndofta brënda në pak kohë, në qoftë se Shqiptarët janë gatë të më ndihnin, sikundër më ndihne me të shtypurit e këtyre dy librave. Më të kthyer të kësaj libre u-*

<sup>28</sup> Dh. S. Shuteriqi "Anonim i Elbasanit", Buletin i Institutit të Shkencave, viti III, 1949, Nr. I, faqe 45.

<sup>29</sup> Dh. Beduli "Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë", dorëshkrim pranë Arkivit të Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë, faqe 7.

përpoqa të mos largohem nga teksti gërqisht dhe besoj që u dhashë Shqiptarëve një kthim exakt të lutjeve të kishës Orthodoxe. Natyrisht nukë munt të mbetesha i kënaqur nga kthimet e vietëra të atdhetarit të shkëlqyer z. K. Kristoforid, dhe u përpoqa t' i ndreq atô që hynë në këtë librë pas përparimit që ka bërë gjuha shqipe që nga koh' e tij, pa mohuar që pun' e tij qe një ndihmë dhe themelî për mua... Shpërej se shpejt do t' kuptohet nevoja e librave të tiera që po përgatit, dhe kiô gjë do t' më bëjë të punoj me më shumë mall e qëndrim".

Në këtë parathënie del qartë qëllimi kryesor dhe i ngutshëm i Nolit, si dhe puna e tij e palodhur për realizimin e tij në dobi të Kishës e të atdheut.

### ***3. Libre é te Krémtévé te Medha te Kishes Orthodoxe, Boston Mass, 1911.***

Përmban himnet kryesore të të kremteve të mëdha të Kishës, bashkë me pjesën e Apostullit dhe të Ungjillit, ungjijtë mëngjesorë të të dielave, si dhe Apostujt dhe Ungjijtë e të dielave në meshë, që nga e Diela e Gjithë Shenjtorëve te e Diela e Fariseut dhe e Kumerqarit. U botua në Boston Mass, më 1911. Është një përmbledhje e të 12 mineove (mujoreve) të Kishës.

Të dy librat e sipërm, Noli ia kushton në shenjë mirënjohjeje e reverimi Imzot Platonit, kryepiskopit rus të Amerikës së Veriut dhe të Viseve Aleutine, për ndihmën që ai i dha kauzës së Kishës sonë.

Edhe botimin e tretë Noli e shoqëron me një parathënie, në të cilën thotë: "Duké shtypur ketê libre çgarkohém nga nje barre dhé mé gas shoh qe me mbétét vétém dhé një libre fétaré êdhé per te botuar. Kio do te jéte Triodi dhé Péntékostari i Vogel, te cilen do t'a kém gatî nga véra qe vjén. U lutém Shqiptarévê te me ndihmojne dhé per ketê libre te funtmé, é cila do te mbushe sérine é tékstévê fétaré Orthodoxé shqipé më té névojshimé dhé do té me lère te lire te mérrém mé kthimé véprash létraré, per te cilat kombi yne ka aqe névoje".

Dhe përkthimi e botimi i tyre vazhdon.

### ***4. Triodi i Vogel, Boston Mass, 1913.***

Përmban himnet e mbrëmësore dhe të mëngjesit të të dielave të periudhës së Kreshmëve të mëdha, duke filluar me të Dielën e Kumerqarit dhe Fariseut dhe duke mbaruar me të Shtunën e Madhe, shërbesën e Pasdarkës së Madhe e të Vogël dhe Himnin Akathist. Disa të diela i ka të plota, disa jo, si p.sh. të dielën II, IV e V të Kreshmëve. U botua në Boston Mass, më 1913.

### ***5. Lutjesorja, Boston Mass, 1914.***

Përmban himnet e mbrëmjes dhe të mëngjesit të të tetë tingujve të Kishës vetëm për të dielat dhe pa kanonet; gjithashtu përmban dhe kanonin paraklitik (lutësor) të madh e të vogël (të Hyllindëses Mari). Është përkthimi i Oktoikut (Tetë Tingujve) të vogël të Kishës. Disa nga himnet e këtij libri qenë përfshirë dhe te "Librë e Shërbesave të Shënta". U botua në Boston Mass, më 1914.

### ***6. Pesëdhjetorja e Vogël, Boston Mass, 1914.***

Përmban shërbesën e plotë të së Dielës së Pashkës së Madhe bashkë me mbrëmësoren, himnet e mbrëmjes dhe mëngjesit të të dielave të tjera të periudhës së Pentikostisë, me Apostullin dhe Ungjillin e ditës, me përjashtim të së Dielës së Gjithë Shenjtorëve, si edhe shërbesën e Shestjes. Është një përmbledhje e Pentikostarit të Madh të Kishës. U botua në Boston Mass, më 1914.

Siç del nga vetë përmbajtja e librave të përkthyer dhe të botuar, si edhe nga të dy parathëniet e paraqitura më lart, synimi kryesor dhe imediat i Imzot Nolit në kushtet e atëhershme ishte që në një kohë sa më të shkurtër t'u jepte shqiptarëve orthodhoksë të përkthyer në gjuhën shqipe pjesët më të nevojshme të Kishës, në mënyrë që ajo të shkëputej nga ndikimi grek dhe me punën që bëri në këtë drejtim, ai ia arriti plotësisht qëllimit.

Librat e tij, të pritur me gëzim nga të gjithë patriotët shqiptarë orthodhoksë dhe të përhapur gjerësisht nëpër komunitetet orthodhokse shqiptare të Amerikës, të Bukureshtit e të Sofjes, si dhe në vetë Shqipërinë e robëruar, ku gjaku i Papa Kristo Negovanit dhe përpjekjet e Atë Stathi Melanit, të Petro Nini Luarasit, të "Lidhjes Orthodhokse" të Mihal Gramenos dhe të aq patriotëve të tjerë e kishin çarë disi rrugën për përdorimin e gjuhës shqipe, i sollën një kontribut të madh dhe çështjes kombëtare dhe gjuhësore<sup>30</sup>.

Autoritetet e larta kishtarë të Shqipërisë së robëruar, në fillim nuk i dhanë dhe aq rëndësi përhapjes së librave liturgjike shqipe, duke kujtuar se kjo lëvizje s'do të kishte sukses, pasi ata kishin pas vetes pjesën më të madhe të klerit dhe të popullit, pjesë e cila nuk e kishte kuptuar ende që njeriu mund t'i falej Perëndisë fort bukur dhe në gjuhën shqipe. Po kur panë se kjo lëvizje po përparonte dhe se besnikët nisën të kërkonin me këmbëngulje që librat të përdreshin dhe në Kishë, në vend që të mbanin një qëndrim korrekt, konform frymës dhe traditës së Kishës Orthodhokse ndaj këtij problemi, filluan të merrnin masa të ndryshme, që ishin në dëm të vetë interesit të Kishës; ndalonin priftërinjtë t'u bënin shërbime atyre që ishin me mendime të tilla, sillnin çdo lloj pengese që këta të mos bënin pjesë në këshillat kishtarë, etj.<sup>31</sup> Megjithatë, lëvizja jo vetëm që nuk u shua, por përkundrazi, pas shpalljes së pavarësisë së atdheut më 1912 dhe formimit të shtetit shqiptar më 1920, u forcua edhe më tepër.

\* \* \*

Kongresi Kishtar i Beratit, i cili më 12 shtator 1922 shpalli autoqefalinë e Kishës sonë, në artikullin 10 të Statutit kishtar caktoi si gjuhë zyrtare të Kishës, si në korrespondencë, ashtu dhe në shërbesat fetare, gjuhën shqipe.

Kështu, pas një periudhe kaq të gjatë përpjekjesh, gjuha shqipe, gjuha e

---

<sup>30</sup> Vehbi Bala, "Fan S. Noli dhe poezia e tij". Shih "Album" të F. S. Nolit, Tiranë, 1958, faqe 4.

<sup>31</sup> Dh. Beduli "Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë", faqe 8-10.

popullit tonë, zuri vend njëherë e përgjithmonë në Kishë.

Para Kongresit Kishtar të Beratit, përveç botimeve të Imzot Nolit janë përkthyer dhe botuar dhe këto libra:

### ***1. Libër për Te Deume të Kishës Orthodhokse, Bukuresht, 1916.***

Përkthyer nga rumanishtja nga arkimandrit **FOTI G. BALLAMAÇI**.

Përmban Te deume për motin e ri, për të kremte kombëtare, ditën e emrit të Mitropolitit apo të episkopit, kur fillon viti shkollor, për çdo përhirim, për çdo mirëbërje që kemi marrë prej Perëndisë, kur hapet Sinodhi i Shenjtë dhe kur mbledhet parlamenti.

Është botuar në Bukuresht, më 1916, me ndihmën e Komunitetit Orthodhoks Shqiptar të Bukureshtit. I është kushtuar në shenjë reverimi dhe mirënjohjeje arkiepiskopit dhe mitropolitit të Ungro-Vllahisë, z. z. Konon, i cili mbrojti dhe përshëndeti me nxehtësi komunitetin e orthodhoksëve shqiptarë në Bukuresht. Është një libër tipik për Kishën Rumune, që nuk figuron si libër liturgjik ndërmjet librave liturgjikë të Kishës Orthodhokse.

### ***2. Urimtore e Shërbesës Mbrëmësore, Worcester Mass të Amerikës, 1920,*** përkthyer nga prifti orthodhoks **P.T. SINICA**, më 1920. I është kushtuar si shenjë nderimi H. Tij, Imzot Theofanit, themelonjësit të Kishës Kombëtare. Është botuar në Worcester Mass të Amerikës, më 1920.

Përmban lutje të mëngjesit dhe të mbrëmjes, simbolin e besës, urata të ndryshme, urata të drekës e të darkës, përlëshore të provimeve shkollore, kanonin e vogël (paraklis), bekimin e pesë bukëve, ngritjen e bukës (ipsomën), urata për lehonën ditën e parë, ditën e dyzetë dhe kur ajo dështon, urata për të sëmurin, shërbesën e orës së nëntë dhe shërbesën e mbrëmjes. Me përjashtim të kanonit të vogël, të simbolit të besës, si dhe të disa himneve dhe psalmeve, pjesa tjetër, më e madhja, është punë e Atë Sinicës.

*"Po u fal besnikëve orthodhoksë, - thotë Atë Sinica në parathënie, - këtë libër të vogël, i cili do t'ua shërbejë mjaft të gjithë atyre që dëshirojnë të mësojnë lutjet kryesore të krishterimit, dhe më tepër këshilloj gjithë prindërit që t'ua rrënjosin bijve që në vogëli bashkë me ushqimin e tyre. Nuk munda të kënaqem vetëm deri këtu, duke parë që dhe shumë lutje që na mungonin, i përktheva sipas fuqisë dhe ia dhashë H. Tij Peshkopit Theofan për t'i korrektuar... "*

Sidomos pjesa e dytë e librit, që përfshin bekimin e pesë bukëve, ngritjen e bukës, uratat në raste të ndryshme të orthodhoksëve, orën e nëntë etj., që plotësojnë veprën e Imzot Nolit, ka mbushur një zbrazëti të domosdoshme për priftërinjtë.

\* \* \*

Në periudhën ndërmjet Kongresit Kishtar të Beratit, më 1922 dhe atij të Korçës, më 1929, që është dhe periudha e përpjekjeve për njohjen e Autoqefalisë së Kishës sonë nga Patrikana Ekumenike dhe nga Kishat e tjera Orthodhokse, është bërë vetëm ky botim:

*“Librë e shenjtë (çkëputur nga librë e Meshës) e Mbrëmësore, e Mëngjesit dhe e Meshës së Shenjtë të Atit Shën Joan Gojëartit, Korçë, 1922”.*

Përmban këndimet më të nevojshme për priftërinjtë shqiptarë dhe shtypet **me lejen dhe pëlqimin e Këshillës së Lartë Kishtare**, Korçë 1922.

Siç theksohet dhe në vetë titullin e librit, pjesët që përmban ky, janë marrë nga Libri i Shërbesave të Shenjta të Imzot Nolit. Ka vetëm këtë ndryshim: para çdo pjese është vënë edhe termi në gjuhën greke; kjo për të ndihmuar priftërinjtë që të orientoheshin më mirë në kryerjen e shërbesave në gjuhën shqipe sipas rregullit që ata kishin mësuar në gjuhën greke. Veç kësaj, libri është parë dhe nga pikëpamja gjuhësore. Janë ndrequr mjaft emra dhe fjalë që Imzot Noli i ka përdorur të latinizuara, si p. sh. Iisu për Jesu, profit për profet, mirënderim për devotesë, perëndilindëse për hyjlindëse etj.

\* \* \*

Në mars të vitit 1929, meqë tratativat me Patrikanën Ekumenike s'po jepnin ndonjë rezultat dhe Kisha ishte pa udhëheqje kanonike, formohet, pa pëlqimin e Patrikanës, Sinodhi i Parë i Kishës sonë dhe në qershor të atij viti mbledhet në Korçë Kongresi i Dytë Kishtar, i cili votoi dhe Statutin definitiv të Kishës<sup>32</sup>.

Sinodhi, menjëherë pas Kongresit, u mor me çështjen e pajisjes së kishave të qyteteve dhe të fshatrave me librat më të domosdoshëm liturgjikë në gjuhën shqipe, sepse një pjesë e librave të botuara nga Imzot Noli në Amerikë, si Libri i Shërbesave të Shenjta dhe ai i të Kremteve të Mëdha, qenë mbaruar dhe gjendeshin shumë rrallë. Pra, paraqitej, nevoja e ribotimit të tyre dhe e përpilimit të Apostullit dhe të Ungjillit, të ndarë në perikopa, sipas tipikosë së Kishës. Për këtë qëllim u formua NJË KOMISION NËN KRYESINË E KRYEEPISKOPIT TË ATËHERSHËM, VISARION XHUVANI, ME ANËTARË IKONOMIN E MADH ATË VASIL MARKO, PROF. SOTIR PAPAKRISTON DHE PROF. KOSTAQ CIPON, komision i cili mori në shqyrtim të dy tekstet: Librin e Shërbesave të Shenjta dhe atë të Kremteve të Mëdha. Komisioni bëri korrektimet e duhura, që kërkonte zhvillimi që kishte pësuar gjuha shqipe gjatë 20 vjetëve, që nga botimi i parë i teksteve të përkthyer e të botuara nga Imzot Noli, pa bërë ndonjë shtesë, përveç heqjes nga libri i të Kremteve të Mëdha të Ungjijve dhe Apostujve, që do të përfshiheshin në libra më vete. Nga ana tjetër u përgatitën Ungjilli dhe Apostulli sipas tipikosë së Kishës, në bazë të tekstit të Dhiatës së Re në dialektin jugor të Konstandin Kristoforidhit, pa bërë asnjë ndryshim gjuhësor.

Të aprovuara sipas rregullit nga Sinodhi i Shenjtë, këto u botuan si më poshtë:

### *1. Librë e Shërbesave të Shenjta të Kishës Orthodhokse. Korçë,*

---

<sup>32</sup> Dh. Beduli “Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë”, faqe 11.

1930.

**2. Ungjilli i hyjnuar dhe i shenjtë. Tiranë, 1930.**

**3. Apostulli**, domethënë Veprat dhe Letrat e Apostujve të Shenjtë, që këndohen në kishë për gjithë vitin. **Tiranë, 1931.**

**4. Libri i të kremteve të mëdha.** Shkurtim i dymbëdhjetë mujoreve të Kishës Orthodhokse. **Tiranë, 1931.**

**5. Në vitin 1931** është botuar, po me pëlqimin e Sinodhit dhe "**Shërbesa e Vajit të bekuar**", i vetmi libër liturgjik mund të themi, që u përkthye dhe u botua nga Kisha gjatë gjithë periudhës 20-vjeçare, ndërmjet Kongresit Kishtar të Korçës (1929) dhe atij të Tiranës (1950).

Dhe kjo është ana më negative për udhëheqësit shpirtërorë të Kishës të kësaj periudhe, të cilët me të ardhurat që kanë pasur në dispozicion nga pasuritë e mëdha manastiriale dhe kishtare dhe me kapacitetin e tyre teologjik, kishin mundësi për të vazhduar veprën fisnike të shqipërimin të librave liturgjike, të nisur prej shekujsh, për kombëtarizimin e plotë të Kishës sonë.

Ata janë kënaqur vetëm me dy përkthime të vogla, të botuara më tepër në mënyrë personale si:

**1. Jetëshkrimi dhe akolluthia e dëshmorit të ri dhe isapostullit Shën Kozma.** Kthyer nga greqishtja prej klerikut orthodhoks Kr. K. (KRISTOFOR KISI), faqe 49. **Korçë, 1931.**

**2. Shërbesa e shenjtë e Shën Joan Vladimirit, çudibërësit, Mbretit të lavdueshëm dhe dëshmorit të madh.** E përkthyer dhe e botuar me bekim të Kryepiskopit të gjithë Shqipërisë Kr. H. Tij Imzot Dr. VISARIONIT, pjesa e parë, faqe 16. **Tiranë, 1934.**

Përkundrazi, iniciativat personale nga ana e klerit dhe e besimtarëve në këtë drejtim kanë qenë shumë më të mëdha, megjithëqë ato s'kanë pasur asnjë nxitje dhe përkrahje nga ana e udhëheqjes së Kishës.

Gjatë po kësaj periudhe, janë bërë dhe këto përkthime në dorëshkrim:

ATË KRISTO KONOMI, famulltar i katundit Shën Vasil të Sarandës, ka përkthyer<sup>33</sup>;

**1. Meshën e Shën Vasilit**, (të plotë)

**2. Uratat falenderuese të kungatës**

**3. Shërbesën e orës së nëntë**

**4. Të shtatë urimet e agimit ( Lyknikët)**

**5. Shërbesën e bukë-prerjes**

**6. Shërbesën e pasdarkës**, (komplet me shërbesën përgatitëse për

---

<sup>33</sup> Revista "Predikimi" organ shpirtnuer, shoqruer - kombëtar i Kishës Orthodhokse Autoqefale, Nr. 44, 31 Mars 1935, faqe 8.

kungimin hyjnor sipas rregullave priftërore)

## **7. Urimet e Hyjlindëses.**

Gjithashtu janë përkthyer:

**1. Mesha e Dhuratave të Parashenjtëruara** nga DH. BEDULI, aprovuar dhe nga Sinodhi i Shenjtë.

**2. Shërbesa e plotë e rrëfimit** nga Dh. Beduli. **Tiranë 1940.**

\* \* \*

Ndërkaq edhe Imzot THEOFAN NOLI e vazhdon punën. Përkthen pjesë të reja, rishqyrton librat e botuar, i risistemon dhe i përgatit për t'u ri botuar nga Peshkopata Orthodhokse Shqiptare në Amerikë.

**Në vitin 1941** del **"Uratorja e Kishës Orthodhokse"**<sup>34</sup>. Është përkthimi i librit liturgjik të Kishës Orthodhokse që njihet me emrin "Efhollógjion to méga", por me disa ndryshime të vogla:

"Kjo liber, - thotë Imzot Noli në parathënie, - *permbán* Sherbesat kryesore te Kishes Orthodokse. Disá prej ketyre botohen per heren e pare ne gjuhen tone, si Mesha e Shen Basilít, Mesha e Shen Grigorít, Rrëgulla e Meshes Peshkopale, Sherbesa e Miros, Martesa e Dyte, Dorezimet, Gradimet, Dedicata e Kishes, Varrimi i Prifsterinjve, Varrimi ne Javen e Pashkes, Varrimi i Femíjeve, Sherbesa e Lanjtores dhe Uratat e Ndryshme. Nga kjo pikepamje, kjo liber ploteson nje nevojë urgjente te Kishes sone kombetare. Nga ana tjater, edhe Sherbesat, qe jane botuar mé pare, ribotohen ketu te ndrequra dhe te permiresuara. Disá prej Urátave jane shkurtuar, dhe disa kendime jane lenë jashte jo vetem per te kursyer harxhet, po me teper nga shkaku, qe ato figurojne vetem ne librat dhe kurre nuk kendohen. Troparet e Pershëmbellta (Prosomia) jane kthyer jo me nje mënyre literale (letrare), por si vjersha pas rithmit te tyre, keshtú qe, kendimi i tyre do te jete fare i lehte per psállterit, qe dine mellodite bizantine origjinale. Duhet vene re se ne ketó Tropare, vírgullat kane nje kuptím mellodik dhe caktojne fundin e frázave muzikale. Ne funt te libres u-shtua nje Tabelle e Páshkeve dhe te krémteve levizore qe me 1942 gjer me 1978 pas Kalendarit te Ri."

**Në vitin 1947** del **"Kremtorja e Kishës Orthodhokse"**<sup>35</sup>. Eshtë bashkimi i të dy librave të botuara më parë: i Lutjesores dhe i Librës së të Kremteve të Mëdha, të dy të rishqyrtuar e më të plotë, siç theksohet dhe në parathënie:

"Kjo liber, sipas titullit *permbán* kendimet e te krémteve kryesore te palevízura te dymbedhjetë múajve. Ne ketó shtuam te dy Kanunet e Shen Marise, Lutesoren dhe Dieloren, domethene Troparet e te Tete Tíngjeje me Apostujte dhe Ungjíjite, qe kendohen ne te Díelat e zakonta te motit. Pothuaj te gjitha Troparet jane artuar pas

<sup>34</sup> Uratore e Kishës Orthodokse. E përktheu Imzot Noli. E botoj Peshkopata e Amerikës. Boston Mass, 1941.

<sup>35</sup> Kremtore e Kishës Orthodokse, E përktheu Imzot Fan S. Noli, E botoj Peshkopata e Amerikës, Boston Mass, 1947.

*rithmeve dhe melodive Bizantine. Perktimin e kemi bere lirisht, pas kuptimit dhe jo fjale per fjale, nga Gërqishtja, me perjashtimin e kendimeve te Shen Kozmájt te Beratit, te cilat i parafrazuam nga versioni Shqip, i Krye-Hiresise se Tij Imzót Kristofór Kisit, Kryepeshkopit te Shqiperise. Nje pjese e madhe e ketyre Tropáreve botohen ketú per heren e pare. Qe te gjitha kendimet, qe jane botuar mé pare, dalin tani ne drite te revizúara...".*

***Në vitin 1952 del "Triodhi dhe Pesëdhjetorja"***<sup>36</sup>.

Edhe ky libër përbëhet nga bashkimi i dy botimeve të mëparshme të Triodhit dhe të Pesëdhjetores së Vogël, të rishqyrtuara dhe tek tuk më të plotësuar.

Këto ribotime të Imzot Nolit, ndonëse më të plota nga përmbajtja, lënë shumë për të dëshiruar përsa i përket besnikërisë ndaj origjinalit, që është në përdorim në të gjithë Kishën Orthodhokse Lindore. Siç e thekson dhe në parathëniet, Imzot Noli ka bërë përkthim të lirë, ka shkurtuar pjesë për hir të melodisë dhe të ritmit muzikor, ka bërë ndryshime, të cilat fatkeqësisht nuk lejojnë që këto libra të përdoren në Kishë si tekste zyrtare, ndonëse janë shumë të mira nga pikëpamja e përshtatjes muzikore bizantine. Siç dihet, asnjë Kishë Orthodhokse nuk ka cënuar sadopak përmbajtjen për hir të melodisë e të ritmit muzikor dhe kjo çështje kurrë nuk ka dalë mbi atë të ritit liturgjik. Uniteti i ritit liturgjik është një traditë e vjetër dhe një nga parimet kryesore të unitetit të besimit të Kishës Orthodhokse Lindore, pjesë përbërëse dhe e pandarë e së cilës është dhe Kisha Orthodhokse e Shqipërisë.

\* \* \*

Veç botimeve të mësipërme, në periudhën pas çlirimit janë bërë dhe këto përkthime:

***1. Shërbesa e dëshmorit të madh Shën Prokop.*** E përktheu **DH. BEDULI** dhe i është paraqitur nëpërmjet Këshillit Kishtar të Komunitetit Orthodhoks të Tiranës për shqyrtim dhe aprovim Kryesisë së Kishës Orthodhokse Autoqefale.

***2. Shërbesa e përgatitjes për kungim dhe e falenderimit pas kungimit,*** përkthyer dhe kjo nga Dh. Beduli.

Dhe me këto mund të themi se mbyllet përshkrimi kronologjik i përkthimeve dhe i botimeve të librave liturgjike të Kishës në gjuhën shqipe dhe i përdorimit të tyre në Kishë.

### III

Përkthimi i një teksti liturgjik kishtar është shumë më i vështirë se përkthimi i çdo lloj teksti tjetër letrar. Ai kërkon që përkthyesi të jetë jo vetëm

---

<sup>36</sup> Triodi dhe Pesëdhjetorja, E përktheu Imzot Fan Stilian Noli, E botoj Peshkopata e Amerikës, Boston Mass, 1952.

njohës i thellë i gjuhës shqipe dhe i gjuhëve kishtare të huaja, nga të cilat përkthen, (për t'i dhënë versionit shqip bukurinë e shprehjes së gjuhës sonë), por edhe njohës i thellë i disiplinave të ndryshme teologjike: të dogmatikës, të historisë së Kishës, të liturgjikës dhe të tipikosë, të Ermineutikës (Interpretimit) dhe të Shkrimeve të Etërve të Shenjtë, për t'u dhënë shprehjeve edhe kuptimin e drejtë orthodhoks; njëkohësisht duhet të jetë dhe një njohës i mirë i melodive kishtare bizantine, në mënyrë që pjesa e përkthyer t'i përshtatet melodisë origjinale të saj, pa u larguar nga teksti origjinal.

Të para nën këtë prizëm, përkthimet tona të deri tanishme, me përjashtime të pakta, paraqesin mjaft të meta. Nuk do të hymë në ndonjë analizë në këtë drejtim. Sjellim si shembull vetëm një rast karakteristik dhe me rëndësi nga pikëpamja dogmatike-parimore, frazën nga artikulli VIII i Simbolit të Besimit Orthodhoks, që flet për rrjedhjen e Shpirtit të Shenjtë dhe që përbën një nga pikat dalluese të Kishës Orthodhokse.

Në origjinal kjo frazë është: *“Καί εἰς τὸ πνεῦμα τὸ Ἅγιον... τὸ ἐκ τοῦ πατρὸς ἐκπορευόμενον”*. Imzot Noli e ka përkthyer: *“Dhe me Shpirtin e Shenjtë ... që dërgohet prej Atit...”*. Kështu ka kaluar kjo frazë dhe në ribotimet e mëvonshme, ndonëse këto janë parë nga komisione dhe janë aprovuar nga Sinodhi i Shenjtë<sup>37</sup>.

Dhe sa i gabuar është ky përkthim nga pikëpamja dogmatike orthodhokse, s'është nevoja të provohet, sepse e di dhe orthodhoksi më i thjeshtë. Janë shkruar me qindra e qindra vepra që nga koha e Etërve të Shenjtë e deri në kohën tonë, për ta bërë sa më të qartë kuptimin e shkakut të parë të rrjedhjes së Shpirtit të Shenjtë dhe të së drejtës të dërgimit të tij në botë.

Më i saktë në këtë drejtim është Kristoforidhi, i cili në Ungjillin pas Joanit e ka përkthyer këtë frazë jo me fjalët *“që dërgohet prej Atit”*, por me shprehjen *“që del prej Atit”* dhe që është më e drejtë nga pikëpamja orthodhokse<sup>38</sup>.

Gabime të tilla të rëndësishme parimore si edhe gabime shprehjesh që nuk i përshtaten strukturës së gjuhës sonë ka mjaft dhe për pasojë këto pjesë mbeten të errëta e të pakuptueshme.

Natyrisht, kjo nuk e pakëson aspak vlerën e madhe që kanë këto përkthime dhe as punën shumë të çmuar të përkthyesve, të cilët me shumë përpjekje dhe kurajo, në rrethana jashtëzakonisht të vështira, çanë rrugën në këtë drejtim.

Ky fenomen ka ndodhur dhe në Kishat e tjera orthodhokse. Ato, më vonë sa herë u është paraqitur nevoja e ribotimit të ndonjë teksti liturgjik kishtar të përkthyer në gjuhën e tyre, me anë komisionesh të posaçëm bënin korrektimet e duhura në tekst, jo vetëm nga ana e zhvillimit të gjuhës, por edhe nga pikëpamja e përcaktimit sa më të qartë të termave teologjike, për t'ia përshtatur këtë sa më shumë origjinalit.

---

<sup>37</sup> Librë e Shërbesave të Shenjta të Kishës Orthodhokse, Korçë, 1930.

<sup>38</sup> Ungjilli i hyjnuar dhe i shenjtë, Tiranë, 1930, faqe 145.

Kështu po vepron dhe Kisha jonë. Meqë tani na u paraqit nevoja për të ribotuar Librin e Shërbesave të Shenjta, me iniciativën e ndritur të Kryehirësisë së Tij, Kryeepiskopit të gjithë Shqipërisë Imzot Paisit, Sinodhi i Shenjtë, i cili i ka kushtuar një vëmendje të veçantë pajisjes së plotë të Kishës sonë me libra liturgjike në gjuhën amtare, në mbledhjen e datës 9.8.1958, vendosi formimin e një komisioni të posaçëm për ta rishqyrtuar dhe plotësuar këtë libër, në mënyrë që ky të jetë më i përsosur si nga pikëpamja gjuhësore, ashtu dhe nga ana parimore.

Dhe në bazë të shkresës Nr.43, datë 25.10.1958 të Kryesisë së Kishës, **KOMISIONI U FORMUA NGA PROF. SOTIR PAPAKRISTO, NIKO ÇANE, DHIMITËR BEDULI DHE DHIAKON SOTIR KANXHERI.**

Për rishqyrtim dhe plotësim u mor si bazë:

"Librë e Shërbesave të Shenjta të Kishës Orthodhokse", Shtypshkronja dhe Libraria Dhori Koti, Korçë 1930.

Por, komisioni ka pasur parasysh dhe botimin e parë të Imzot Nolit.

Si tekst origjinal në gjuhën greke janë përdorur botimet e mëposhtme:

1 – Η Θεία λειτουργία περιέχουσα τόν Ἐσπερινόν, τόν Ὄρθρον τήν Προσκομιδήν, τήν Λειτουργίαν τοῦ Ἰωάννου τοῦ Χρυσσοστόμου, Βασιλείου τοῦ Μεγάλου καί τήν Προηγιασμένην Γρηγορίου τοῦ Διαλόγου κ.τ.λ. ὑπό Ι. Καρυοφίλλη, Ἐκδοσις Τρίτη, Ἀθήναι, 1896.

Këtë tekst e ka pasur parasysh dhe Noli gjatë përkthimit të parë, gjë që rezultoi nga renditja e lëndës dhe nga shënimet

2 – Η Θεία Λειτουργία ἤτοι ἱεροτελεστικόν τέυχος, ἠρμηνευμένον ὑπό Ἱερονύμου Βογιατζή Αρχιμανδρίτου, Ἐκδοσις ἕκτη, Ἀθήναι, 1912.

3 – Εὐχολόγιον τό Μέγα, Ἐκδοσις ἕκτη, Βενετία, Ἐκ τοῦ Ἑλληνικοῦ Τυπογραφείου Ὁ Φοῖνιξ, 1891.

4 – Ὡρολόγιον τό Μέγα, Ἐκδοσις ἕκτη, Βενετία, Ἐκ τοῦ Ἑλληνικοῦ Τυπογραφείου Ὁ Φοῖνιξ, 1891.

Përveç tekstit origjinal në gjuhën greke, komisioni ka patur si bazë dhe:

1 – Dumnezeestile liturghii ale sfintilor parintilor nostri Ioan Gura de Aur, Vasile cel mare si Grigorie Dialogul, Bucuresti, 1950.

Për pjesët biblike (psalme, ungjij, apostuj) dhe për termat e ndryshme liturgjike kemi patur parasysh:

1 – Τά Ἱερά Γράμματα, Ἐν Ὁξωνία, 1925.

2 – Η Παλαιά Διαθήκη κατά τούς ἑβδομίκοντα, Ἐγκρισει τῆς Α. Ἱεραῶς Συνόδου τῆς Ἐκκλησίας τῆς Ἑλλάδος, Ἐν Ἀθήναις, 1928.

3 – Biblija, ili knjigi svjashennovo pisanija vethovo i novovo zavjeta n ruskoj perevodje, Izdanie Moskovskoi Patriarhii, Moskva, 1956.

4 – Biblia, sau sfanta Scriptura a Vechiului si Noului Testament Cu aprobarea Sh. Sined, Bucuresti, 1940.

5 – Ἑρμηνεία εἰς τήν Καινήν Διαθήκην ὑπό Νικολάου Δαμαλά, Ἐν Ἀθήναις, 1876.

6 – Liturghica Bisericii ortodoxe, Cursuri universitare.

Komisioni është përpjekur që çdo pjesë ti japë shprehjen shqipe sa më të qartë, pa iu larguar tekstit origjinal, shprehje që njëkohësisht t'i përgjigjen frymës orthodhokse.

Gjithashtu është përpjekur, të përcaktojë sa më qartë termat me karakter dogmatik, duke përdorur sa më pak fjalë të huaja.

Por, komisioni ka lënë dhe mjaft terma liturgjikë siç janë në origjinal, jo vetëm pse ato kanë hyrë tashmë në gjuhën tonë kishtare, por edhe sepse po kështu përdoren dhe në të gjithë Kishat e tjera Orthodhokse të botës.

Libri është plotësuar me këto pjesë të reja:

1. Uratat e fillimit të shërbesës së Mbrëmësores, paravargjet e javës dhe bekimi i pesë bukëve (artoklasia).

2. Uratat gjatë gjashtë psalmeve në shërbesën e mëngjesit.

3. Liturgjia e Shën Vasilit të Madh.

4. Liturgjia e Dhuratave të Parashenjtëruara.

5. Shërbesa e përgatitjes për kungim dhe e falenderimit pas kungimit.

6. Përlëshimet e ndryshme gjatë vitit.

7. Shërbesa e martesës së dytë.

8. Shërbesa e varrimit të foshnjave.

9. Urata në raste të ndryshme të jetës kishtare.

Është plotësuar, gjithashtu dhe me një shumicë shënimesh tipikonale (tipikoje), për të lehtësuar sidomos ata priftërinj dhe psaltë që nuk dinë gjuhën greke, për të ndjekur rregullin sipas tipikosë së Kishës, që ende nuk është përkthyer shqip dhe që s'ka mundësi të përkthehet, pa u përkthyer më parë të gjithë librat e tjerë liturgjikë.

Janë lënë jashtë këtij libri: Stihirat (vargëzimet) e mbrëmësores e të lavdërimeve të mëngjesit, eksapostillarët (dërgimsoret), lavditë e mëngjesit (eothinatë) dhe katavasitë (zbritësoret) e vitit, sepse pjesa më e madhe e tyre përfshihet në librin e Lutjesores, i cili, i rishqyrtuar dhe i plotësuar, do të botohet së shpejti.

Sinodhi i Shenjtë i Kishës Orthodhokse Autoqefale, pasi e pa tekstin, shfaqti pëlqimin e tij për punën e kryer nga komisioni dhe ka bindjen se ky botim *“Libri i Shërbesave të Shenjta të Kishës Orthodhokse (i rishqyrtuar dhe i plotësuar)”*, Tiranë, 1961, plotëson një nevojë të madhe të Kishës sonë dhe të klerit.

## Pasthënie

Ky material është botuar për herë të parë si hyrje në “Libër i Shërbesave të Shenjta”, në vitin 1961. Me rishqyrtimin dhe plotësimin e tij, në botimin e vitit 1994, hyrja me historikun e përdorimit të gjuhës shqipe në Kishë u la jashtë me qëllim që, pasi autori ta plotësonte me të dhëna të reja, të botohej si libër

më vete\*.

Autori, z. Dh. Beduli, kish grumbulluar materialin e nevojshëm për këtë temë, por nuk arriti ta sistemojë e ta përpunojë. Gjatë viteve të fundit, ai ishte mjaft i ngarkuar me detyra imediate të ringritjes nga e para të Kishës dhe sidomos me drejtimin e grupit të përkthim-botimeve të teksteve liturgjike e librave fetare.

Për vlerat që ka ky studim, u mendua të botohej si libër më vete duke u plotësuar edhe me këtë informim:

Fortlumturia e Tij Imzot Anastasi, në fjalimin-program të tij në ditën e fronëzimit më 2 Gusht 1992, shtroi si problem kryesor: *"Urgjente paraqitet nevoja e botimeve kishtare në gjuhën shqipe. Për më shumë se 30 vjet nuk kanë qarkulluar në vend botime orthodhokse, kurse ato që ekzistonin u shkatërruan. ...Një GRUP I PËRHERSHËM PËRKTHIMI INTELEKTUALËSH KOMPETENTË, NËN KRYESINË E TEOLOGUT DHE PËRKTHYESIT TË DËGJUAR Z. DHIMITËR BEDULI, do ta shpjerë më përpara punën përkthyesë, duke vazhduar kështu në kohën tonë përpjekjen që nisi gjatë dekadave të para të shekullit tonë biri i madh i Shqipërisë Fan Noli"*\*\*.

Dhe puna filloi. Gjatë kësaj kohe u rishikuan, u plotësuan me përkthime të reja dhe arritën të botohen nga Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë:

1. *Dhiata e re, Tiranë, 1994.*
2. *Libër i Shërbesave të Shenjta të Kishës Orthodhokse, Tiranë, 1994.*
3. *Liturgjia Hyjnore e Atit tonë ndër Shenjtorët Joan Gojarti, Tiranë, 1995.*
4. *Pasdarka e vogël, Tiranë, 1997.*
5. *Mëngjesorja, Tiranë, 1997.*

Ndërkohë janë gati për botim:

1. *Uratore (Uratore e Vogël) – botuar tashmë Tiranë 2004.*
2. *Dhiata e Re, (e përpunuar dhe e saktësuar në gjuhën e sotme (punuar nga z. Thoma Qendro) – botuar tashmë Tiranë 2005.*
3. Ungjilli Hyjnor dhe i Shenjtë, për përdorim të përgjithshëm në Kishë.
4. Apostulli.
5. Letrat e Apostujve.
6. Psalmet.

Duhet përmendur se gjatë kësaj periudhe të ringritjes së Kishës janë shtypur e shpërndarë në formë dispensash mjaft materiale në ndihmë të priftërinjve dhe seminaristëve.

---

\* "Ngjallja" Korrik 1994

\*\* "Ngjallja" Nëntor 1992

\* \* \*

Teksti i mëposhtëm është botuar si Hyrje në  
Librin e Shërbesave të Shenjta të Kishës Orthodhokse,  
Botim i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë,  
Tiranë, 1994;  
dhe i botuar në gazetën "Ngjallja", Korrik 1994, me titull  
"Kontribut i qenësishëm në përtëritjen e Kishës sonë"  
- u botua libri i Shërbesave të Shenjta të K.O.A.SH. -

Me bekimin dhe përkujdesjen e Kryehirësisë së Tij, kryepiskopit të Tiranës dhe gjithë Shqipërisë, Prof. Dr. Imzot Anastasit, u ribotua teksti liturgjik: "Libër i Shërbesave të Shenjta të Kishës Orthodhokse", i cili është një nga librat më të domosdoshëm e më të përdorshëm për klerin tonë dhe për Kishën.

Ky tekst është përkthyer për herë të parë nga greqishtja në gjuhën shqipe prej të përndershmit Atë Theofan S. Noli dhe është botuar në Boston Mass, të Amerikës, më 1909 dhe ka pasur gjer më sot katër rishqyrtime dhe botime.

*Botimi i dytë është bërë më 1930, në Korçë, pasi më parë u kontrollua nga pikëpamja gjuhësore prej një komisioni shqyrtues të përbërë nga Prof. Sotir Papahristo, Kostaq Cipo, Simon Shuteriqi dhe Ik. Mitr. Atë Vasil Marko, nën kryesinë e Imzot Visarion Xhuvanit, Kryepiskop i atëhershëm i Kishës, pa iu bërë tekstit asnjë ndryshim.*

*Botimi i tretë është bërë nga Peshkopata e Amerikës, më 1941, po në Boston Mass, këtë radhë me një titull të ri: "Uratore e Kishës Orthodhokse", që i përgjigjet tekstit zyrtar të njohur me emrin "Efhollógjion to méga". Ky botim është përpunuar rishtas prej Imzot Nolit, për t'iu përshtatur melodive origjinale bizantine.*

Me epuizimin e plotë të tekstit të botuar më 1930, i cili, nga pikëpamja e përkthimit, i qëndronte shumë më afër origjinalit, është ndër nevoja e ribotimit të tij. *Me vendim të Sinodhit të Shenjtë, më 1958 u formua një komision i përbërë prej z.z. Prof. S. Papakristo, Niko Cane, Dh. Beduli dhe kryedhjakon Sotir Kanxheri, i cili, pasi e rishqyrtoi tekstin nga pikëpamja gjuhësore dhe e plotësoi me pjesë të tjera, (Meshën e Shën Vasilit, Meshën e të Parashenjtëruarave e me një sërë shërbesash dhe uratash të ndryshme, të domosdoshme për priftin e për Kishën), më 1961 e dha për botim. Ishte botimi i katërt i tekstit.*

Ky botim, pra, që ishte më i miri e më i ploti se të gjithë botimet e tjerë të mëparshëm, u mor si bazë për ribotim dhe janë bërë këto ndryshime, që i kërkonte nevoja: Është hequr nga teksti, hyrja me historikun e përdorimit të gjuhës shqipe në Kishë, e cila, pasi të plotësohet me të dhëna të reja nga autori i saj z. Dhimitër Beduli, mendohet të botohet si broshurë më vete. Janë shtuar Katavasi të (zbritësoret) e vitit, të cilat në të tre botimet e para qenë përfshirë

në tekst. Në botimin e katërt qenë hequr, sepse ishin përfshirë në librin e Oktoikut (Tetë Tingullit) të madh, i cili ishte përkthyer i tëri dhe ishte dhënë për botim, por që, me mbylljen e Kishave në vitin 1967, nuk dihet se ku ka përfunduar.

Për të lehtësuar punën e priftërinjve dhe të psaltëve në zbatimin e rregullit për kryerjen e shërbesave sipas Tipikosë së Kishës, janë lënë në tekst dhe të gjitha shënimet tipikonale. Gjithashtu, janë shtuar edhe mjaft udhëzime të reja, që u panë të domosdoshme.

Siç thuhet në hyrjen e shkruar nga Kryepiskopi Anastas, "Çdo klerik orthodhoks, sa herë që Perëndia do ta bëjë të denjë të përdorë këtë libër për të meshuar, ka për detyrë të përgatitet në mënyrë të përshtatshme, të mendojë dhe të ndjejë kuptimin e thellë të gjërave që kryhen, dhe pastaj, i dëlirësuar trupërisht dhe shpirtërisht, me përshtatshmëri të fillojë kryerjen e Liturgjisë Hyjnore, me lutjen e gjithëshpirtshme, që përmbledh urata e Proskomidhisë së Liturgjisë Hyjnore të Shën Joan Krisostomit (Gojartit): " ... Bëna të denjë (o Zot, Perëndi i Gjithëpushtetshëm), të gjejmë hir përpara teje që të bëhet e mirëpritur prej teje therorja jonë, dhe shpirti i mirë i hirit tënd të ngrerë tënden mbi ne dhe mbi këto dhurata që ndodhen përpara, dhe mbi tërë popullin tënd".

Në fund duhet shprehur përgëzim i veçantë për përpjekjet e frytshme të grupit botues, drejtuar nga teologu Dhimitër Beduli, si dhe motrën Argjiro, që u kujdes për realizimin e botimit.

---

**Dhimitër Beduli, "Gjuha shqipe në Kishë",**

(Hyrje në "Libër i Shërbesave të Shenjta", Tiranë, 1961, fq. 3-26;  
dhe botuar në libër të veçantë pas vdekjes, nga i biri z. Kristofor Beduli,  
Botim i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Tiranë, 1997, fq. 3-39)